

**KOMENTET E ÇMIMIT TË PROPOZUAR
TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA ZRrEE**

**Diskutim Publik - Raportet Konsultative per
MAR për PRR 2 (1 prill 2018 - 31 mars 2023)**

TEMPLATE FOR SENDING COMMENTS

Title of the draft Law/concept document/Strategy or other act under public consultation	1.Raport Konsultativ për të Hyrat e Lejuara Maksimale Shqyrtimi Periodik për OST/OT Periudha e Dytë Rregullative (2018-2022) 2.Raport Konsultativ Faktori i Efikasitetit Periudha e Dytë Rregullative (2018-2022) 3.Raport Konsultativ Faktori i Efikasitetit Periudha e Dytë Rregullative (2018-2022)
Public body	ZRrEE
Name of contributor (organisation/individual)	Selatin Kaçaniku - ORGANIZATA KOSOVARE PËR MBROJTJEN E TË DREJTAVE TË QYTETARIT KONSUMATOR DHE TAKSAPAGUES " KONSUMATORI ", Kosovë, Prishtinë,
General comments	Jungjatjeta zonja Murtezaj. Në attach keni kontributin tim modest me komente e propozime lidhur me "Diskutim Publik - Raportet Konsultative per MAR për PRR 2 (1 prill 2018 - 31 mars 2023) ". Ato janë të shënuara me shkronja me ngjyrë të kuqe. Me shpresë se kontributi im modest do t Ju shërbej, Në attach keni edhe kontributet e mëhershme - të cilat nuk janë marrë në konsiderim dhe si të tilla akoma mbeten aktuale. Përshëndetje e suksese. Selatin Kaçaniku, ekspert për kauzën, të drejtat e obligimet, intereset dhe dinjitetin e qytetarit konsumator taksapagues Mësimdhenes ne

	<p>arsimin e lartë; dhe kryetar i</p> <p>Org. KONSUMATORI, Kosovë, Prishtinë, ok.kosova@gmail.com, 044/200-458,</p>
<p>Comments on specific articles or parts of draft act</p>	<p>Çdo Raport, edhe konsultativ, i shërben / i dedikohet një qëllimi.</p> <p>Po të ishte qëllimi i informimit do të quhej ndryshe, nuk do të quhej Raport ?!</p> <p>Cilat janë “ palët e interesit të sektorit të energjisë “ të cilëve i dedikohet / et Raporti / et ?</p> <p>Këto palë, me rrugë e periodikë tjerë tanimë janë të informuara, ashtu siç nuk informohet PALA KRYESORE E INTERESIT, që është qytetari konsumator taksapagues.</p> <p>Trajtimi jo me dinjitet, jo konform ligjeve, mandatit, etkës humane e profesionale...flet qartë për nivelin e akcilit i cili shkel mbi këto dokumente e vlera civilizuese.</p> <p>Kur një dokument, si ky Raport..., nis me arsyetim të pavend flet për ndërgjegjen e aktivizuar me vonesë.</p> <p>KOMENT 1. : Nëse kemi parasysh datën e nisjes së zbatimit, 01.04.2018, vërejmë se ZRrEE-ja është në vonesë të aplikimit të përcaktimit të të Hyrave të Lejuara maksimale (MAR) për OST/OT dhe OSSH. Nëse kemi parasysh edhe periudhën kohore përgaditore, të diskutimit publik prej minimum 6 muajsh, del se ZRrEE-ja është në vonesë prej rreth 10 muajsh. Kjo vonesë e “ arsyeton “ përsheptimin / shkurtimin / kalimin e fazës së diskutimit publik duke dhënë vetëm një paralajmërim të cilin, që në hyrje të Raportit...tenton “ ta zhbëj “ me një arsyetim duke thënë se dokumenti nuk ka formë finale ?!</p> <ul style="list-style-type: none"> - ZRrEE-ja që nga zanafillja e idesë duhet ta kqç qytetarin konsumator taksapagues në debat / diskutim / komentim publik. Ky është obligim ligjor, mandator e etik dhe nuk guxon të varet nga vullneti as interesi i askujt; Në vend të “ sondazhit “ të opinionit, arsyetimit e kërkimfaljes ZRrEE-ja duhet të organizojë studim fizibiliteti, të masë shkallën e arritjes dhe ngritjes së kënaqëshmërisë së qytetarit konsumator taksapagues me cilësinë e produkteve dhe me performancën e shërbimeve; Duhet të caktojë e mbikqyrë kriteret, udhëzimet, normat...standardet e prodhimit,

transmisionit, fakturimit, tenderimit e prokurimit...konform ligjeve e akteve nënligjore - bashk me qytetarin konsumator taksapagues !

- Loja me durimin, me inteligjenën dhe me dinjitetin e qytetarit konsumator taksapagues duhet të mbyllet dhe të mos përsëritet më.

KOMENT 2. : Kur do të fillojë të aplikohet modeli i "...furnizimit të garantuar përmes Furnizuesit të Mundësisë së Fundit (FMF)¹ "...? Oferta e " mundësisë " në letër pa e rrumbullaksuar me ofertën reale, praktike e me kontrata nuk mjafton;

- Te përllogaritja e kostove të KEK-ut mendoj se menjëherë e retroaktivisht duhet të ndalet faturimi i 6,9 % në emër të mbulimit të dëmeve nga shpërthimi në KEK më 06.06.2014;
- Menjëherë duhet të zhdëmtohen 30.000 qytetarët konsumatorë taksapagues të energjisë elektrike me njehsorë digjitalë. Të pakënaqurve t ju ndërrohen njehsorët;

KOMENT 3. : ZRrEE-ja duhet të gjejë " formulë " dallimi mes " eksportit " dhe " depozitimit ", duhet ta ndalojë lojën e eksportit të energjisë vendore me çmim prej 30 EUR / MWh dhe importimin e të njëjtës energji elektrike, por tani si prodhim i huaj, me çmim deri në 182 EUR / MWh. ZRrEE-ja duhet ta ndalojë logjikën e importit fiktiv, importit të manipuluar...; Ndërprerjet e reduktimet e rreme të energjisë elektrike (me qëllim eksporti përfitues), ZRrEE-ja duhet t i ndëshkojë dhe, edhe në këtë mënyrë, ta mbroj qytetarin konsumator taksapagues ?!

- ZRrEE-ja, MF-ja, ATK-ja...Qeveria duhet ta shfaqin TVSH-në, të na dëshmojë e bind se ku shkojnë kontributet tona fiskale, të na bind e dëshmojë se ato nuk keqpërdoren.

KOMENT 4. : ZRrEE-ja nuk ka pasur të drejtë që koston e individëve që konsumojnë energji elektrike e nuk paguajnë t ua faturojë qytetarëve konsumatorë pagues të ndershëm, të kujdesëshëm e me potencë të dukshme të patriotizmit ekonomik. Këtë logjikë e mendësi papërgjegjësie ZRrEE-ja duhet ta dërpres dhe retroaktivisht t i zhdëmtojë qytetarët konsumatorë. Në këtë aspekt, jo vetëm qytetarët

konsumatorë, ZRrEE duhet t i vetëdijësojë edhe zyrtarët e vet, të KEK, të KOSTT, të KEDS, të Qeverisë, të MZHE-së...të cilët mendojnë e janë të bindur, deklarohen edhe publikisht se "...humbjet duhet mbuluar nga qytetari konsumator pagues i ndershëm e patriot ekonomik..." ?!

- Në kontratën me qytetarin konsumator të energjisë elektrike dëmet / borxhet për energjinë elektrike konsumuar e të papaguar nga " pala e tretë " decidivisht është thënë se nuk do të ngarkohet qytetari konsumator. Kjo u tha edhe në press konferencën e Këshillit për Mbrojtjen e Konsumatorit mbajtur në MTI më 30.09.2018.
- Edhe Kryeministri Kosovës publikisht ka premtuar / siguruar se ngritje të çmimit të energjisë elektrike - nuk do të ketë ?!
- Ndaj, me që nuk ekziston baza ligjore, " mbytemi " nga kureshtja që të njihemi me " muzën e frymëzimit " e cila e udhëhoqi ZRrEE-në që arbitrarisht të ngris çmimin e energjisë elektrike për qytetarin konsumator pagues të ndershëm e patriot ekonomik ?!
- Siç e dini, OJQ KONSUMATORI dhe unë për 11 vite vazhdimisht, por pa sukses, po reagojmë kundër padrejtësive, po kërkojmë edhe sot drejtësi, barazi e dinjitet...si dhe zhdëmtim. Për t Ju rikujtuar disa nga " letrat " tona do t i keni përsëri në attach.

KOMENT 5. :- Qytetari konsumator i energjisë elektrike, sipas formulës së përlllogaritjes, sipas asaj që i faturohet, paguan edhe për INVESTIME por që investimi as aksionariteti nuk i njihet. Nuk i njihen aksionet as nga investimet e së kaluarës, ato nga themeli ?!

- Me qe operatorët energjetik akoma nuk i përmbushin shumicën e komponenteve të standardeve socio-ekonomike-teknike-humane-mjedisore-shëndetsore...ZRrEE-ja duhet të insistojë në përmbushjen / zbatimin e tyre konform Direktivave të BE-së e jo konform presioneve politike;

- Raporti / niveli i zbatimit të komponenteve të standardeve duhet të jenë vendimtarë gjatë proceseve të vlerësimit dhe caktimit të çmimeve. Këto procese duhet të angazhojnë edhe qytetarin konsumator takspagues.

- Aplikimi i standardeve është kusht edhe për sigurim e risigurim të

operatorëve nga përgjegjësia ndaj palës së tretë, që në këtë rast është qytetari dhe biznesi konsumator, te kompanitë e sigurimit e risigurimit. Kjo pa aftësi e operatorëve energjetik po ndikon që mos të mbulohen / mos të kompensohen dëmet që operatorët energjetik po ia shkaktojnë qytetarit dhe biznesit konsumator. Kjo na kushtoi e po na kushton tepër shtrenjt para, nga dhe pas datës 06.06.2014, kur ndodhi shpërthimi në KEK - fajtori i të cilit akoma nuk është zbuluar por arbitrarisht e padrejtësisht “ fajtor “ është shpallur qytetari konsumator taksapagues;

- ZRrEE-ja duhet ta anullojë / zhvlerësojë vendimin e përkohëshëm, i cili nuk ka qenë dashtë që si masë e përkohëshme të zbatohet më gjatë se 6 muaj, prej 6,9 % për mbulimin / kompensimin e dëmeve nga shpërthimi në KEK më 06.06.2014, ndërsa teprica e mjeteve të grumbulluara t i kërket qytetarit konsumator;

- ZRrEE-ja duhet ta anullojë “ tarifën për leximin “ e njehsorit që është taksë e kontrabanduar për RTK-në. Kuvendi e Qeveria e Kosovës, bashk me ZRrEE-në, duhet ta lejojnë qytetarin konsumator, edhe të ofertës së Skemave programore të kanaleve të RTK-së, që raportet me RTK-ë t i sqarojë e rregulojë vet;

- ZRrEE-ja duhet t ia ndalojë KEDS-it që kundërligjshëm t i përvehtësojë trafot e pronësisë private të konsumatorëve e bizneseve - si kusht për mirëmbajtje si dhe t i deklarojë ato si investime ?!

- Nëse isha i vëmendshëm në lexim / analizë / studim them se nuk vërejtja askund se po kërkohet / insistohet në kursime e manaxhim të vëmendshëm të aseteve / mjeteve / energjenteve...si dhe në prokurim.

- Ofertat / kërkesat për ofertë në saje të çmimit ekonomikisht më të volitshëm nënkupton ÇMIMIN MË TË VOLITSHËM EKONOMIK KONFORM STANDARDEVE VENDORE DHE TË BE-së. Të bazuarit vetëm në “ çmim “ por jo edhe në “ ekonomikisht më të volitshëm “ dhe jo “ konform standardeve “ flet se gjuha dhe teksti që lënë të nënkuptohet qëllimisht dhe për përfitime personale e grupe po keqkuptohet e kurdiset / manipulohet tenderi ?! Vetëm nga blerja e derivateve të naftës, mazutit...po shpenzohen mbi 40 MLN EUR / vit. Për të mbikqyrë e ulur shpenzimet në këtë sektor të KEK-ut, sepse është dyshuar e po dyshohet për keqpërdorime, janë vendosur edhe kamerat, por...

	<p>- Kontratat / tenderet e pa arsyetuara / të pakompletuara / të dyshuara ZRrEE jo vetëm se nuk duhet tua arsyetojë operatorëve e mbështes por, përkundrazi, duhet t i disiplinohë.</p> <p>- Flitet se deri në 2.5 MLRD EUR i janë dhënë sistemit energjetik të Kosovës si donacione, subvencione, kredi pa kthim...nga miqët ndërkombëtarë. Por, nga ZRrEE-ja nuk kemi informatë as konsideratë...se këto mjete e kanë relaksuar sado pak xhepin dhe obligimet e qytetarit konsumator taksapagues ndaj sistemit energjetik.</p> <p>Ju falemnderit për mundësinë e dhënë që të kontribuoj.</p>
Contact person	Selatin Kaçaniku
Email person	ok.kosova@gmail.com